



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORATI PËR BUJQËSI , PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL

Reference: 12-320

Datë:	05.05.2017
Për:	z.Imri AHMETI - Kryetar i Komunës së Lipjanit
Nga:	Feti KRASNIQI -Drejtore i Drejtoratit për Bujqësi , Pylltari dhe Zhvillim Rural
Lënda:	Raporti mujor i punës për muajin Prillë : 2017

Shtojcë: Raporti i aktiviteteve të Drejtoratit për Bujqësi , Pylltari dhe Zhvillim Rural për muajin Prillë: 2017

DBPZHR ne Lipjan gjatë muajit Prillë 2017 , ka zhvilluar këto aktivitete :

Aktivitete profesionale :

- Takimet javore në Bordin e Drejtorëve
- DBPZHR- ka publikuar njoftimin e Ministrisë së bujqësisë për parashtrimin e kërkesave për vlerësim të dëmeve bujqësore nga ngricat e 22 dhe 24 prillit 2017.
- DBPZHR-ka formuar komisionin përkates për dalje në teren.
- Komisioni perkates i Drejtoratit për bujqësi ka vlerësuar edhe fermer të cilet kanë parashtruar kërkesat e tyre për dalje në vendëshikim, për to janë hartuar procesverbalet e vlerësimeve .
- Raportet e vlerësimeve do të ju dërgohem MBPZHR për kompensim eventual.
- Takimet me stafin lidhur me detyrat dhe përgjegjësitë në punë (Rastet në sektorin e pylltarisë , lista e vijueshmërisë , plani i shfrytëzimit sa më racional të buxhetit).
- Në sektorin e pylltarisë ka vazhduar regjistrimi i terreneve pyjore .
- Mbjelljet pranverore janë në përfundim e siper.
- Nga MBPZHR , janë paraqitur kërkesa të reja që fermerët të cilet kanë aplikua në pagesat direkte për kultivimin e kungullit në sipërfaqe me shumë se 2 hektar , duhet të kenë edhe nga një kontrat me ndonjë kompani të kontraktuar për grumbullimin e farave të tyre. Kjo shkresë ndonëse ka ardhur me vones në adresat e zyrtareve të Drejtoratit tonë ka krijuar disa vështirësi , dhe ne kemi identifikuar ata fermer të cilet kanë probleme të tilla të adresohen në Ministri , përkatesisht në Agjencionin për Zhvillimin e Bujqësisë, për sqarime shtesë.